



Mitrovica

Mitrovica

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullorës për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A, nenit 22 paragrafi 4 i Statuti të Trepça Sh.A, bazuar në Rregulloren për ristrukturimin dhe organizimin e Trepça Sh.A me nr.prot:2776 dhe sipas Rregullores për Sistematizimin e vendeve të punës në Menaxhmentin e Ndërmarrjes Trepça SH.A me nr.prot:2777, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe nevojës së paraqitur për plotësimin e vendit të punës, U.D i Kryeshefit Ekzekutiv i Trepça Sh.A me datë 20.09.2023 publikon këtë

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita: Shef i IT

Vendi i punës: Departamenti i Burimeve Njerëzore (Menaxhment)

Kohëzgjatja e kontratës: e pacaktuar

Orari i punë: I plotë;

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Menaxhon sistemin informativ të menaxhmentit në ndërmarrje.
- Mirëmban aplikacionet softuerike të ndërmarrje.
- Ofron përkrahje profesionale zyrtarëve të departamenteve të tjera dhe shërbimeve logjistike;
- Përcjell dhe ofron përkrahje profesionale në fushën e teknologjisë lidhur me përditësimin e programeve në fushën e teknologjisë informative;
- Përgatit raporte të ndryshme lidhur me inventarizimin e paisjeve të teknologjisë informative.
- Kryen edhe punë të tjera, që i përgjigjen përgatitjes profesionale dhe aftësive të fituara në punë, të kërkuara nga eprori, të cilat nga natyra i përkasin këtij vendi të punës;

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur në pozitën Shef i IT në Departamentin e Burimeve Njerëzore duhet të plotësoj kushtet, si vijon:

- I diplomuar në fushën e teknologjisë informative apo master në fushat përkatëse
- Njohuri e programeve kompjuterike dhe aplikacioneve softuerike dhe sistemit të kamerave.
- Duhet të ketë së paku 3 vite përvojë pune profesionale.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT:

Kandidatët për pozitën Shef i IT në Departamentin e Burimeve Njerëzore duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Aplikacionin(i cili merret në kopje fizike në Trepça Sh.A)
- CV-në;
- Vërtetimin e marrëdhënies së punës në Trepça Sh.A;
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit;
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit)

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

Të interesuarit aplikacionin e plotësuar duhet ta paraqesin në zyrën e protokollit në Trepça Sh.A në PIM.



U.D. Kryeshefi Ekzekutiv

Dr.Sc. Enis Abdurrahmani